

## Iniciativa e Therandës



### Deklarata Politike

Iniciativa e Therandës është bashkim vullnetar i individëve, anëtarëve dhe mbështetësve me pikëpamje dhe vizion për një Kosovë më të përparuar. Misioni ynë është përfaqësimi i qytetarëve të Therandës në përmbushjen e vizionit tonë, me vlera dhe parime dhe kulturë të re qeverisëse. Duke besuar në përfaqësim të përgjegjshëm, me etikë dhe standarde të larta në përmbushjen e aspiratave dhe nevojave të qytetarit tonë.

Synojmë përfaqësim dinjitoz, në respekt të vlerave të individit dhe të shoqërisë, si parimet themelore të një shoqërie demokratike me mirëqenie të individit, familjes, organizimit shoqëror, biznesit dhe mjedisit jetësor.

Iniciativa e Therandës do të jetë model i përfaqësim të interesit dhe zërit qytetar në shpërfaqjen e preokupimeve dhe nevojave të qytetarëve. Do të angazhohet në promovimin e vlerave të qytetarisë aktive në përballje ndaj dukurive negative në edukim, administratë dhe pushtet lokal, me transparencë dhe llogaridhënie të mirëfilltë.

Në Therandë, më 07.07.2017

Gëzim Kryeziu